



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 592/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 02.11.2013 Burim Ramadanin nga subjekti politik AAK ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të formularit për votim përmes së cilës bënë thirrje për ti dhënë votën kandidatit Bali Muharremaj, andaj me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me dispozitat e LZP-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, ora 10:00.

PZAP-i, sipas afatit të caktuar pranoi përgjigjen në ankesë nga AAK-ja e në të cilën theksohet se pretendimet e BIRN-it për thyerje të heshtjes zgjedhore janë të pabazuara pasi që edhe vete kompanitë që menaxhojnë rrjetet sociale e kanë të vështirë të konstatojnë identitetin e individëve që hapin llogari në këto rrjete dhe se AAK me të pranuar njoftimin për ankesën ka kontaktuar Burim Ramadanin dhe i cili e mohon që ai e menaxhon këtë faqe e cila paraqitet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Ankuesi në ankesë pretendon se militantë të subjektit politik PDK me flamuj të subjektit të tyre kanë hyrë në oborrin e shkollës fillore Jusuf Gërvalla ku ka qenë duke u votuar, PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se nga fotot e ofruara si dëshmi nuk shihet shkolla për të cilën pretendon pala ankuese në ankesën e saj dhe se këto prova nuk janë të mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet e tilla andaj një ankesë e tillë është e pabazë dhe se një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si përgjithshëm dhe i pa argumentuar mirë në fakte dhe në dëshmi konkrete bindëse. Andaj PZAP-i duke u mbështetur në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 592/2013 më datën 07.11.2013.



#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*